

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar Nënkryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Jemi në një situatë ku çdo gjë jo normale, kriminale, denigruese dhe shtypëse po kthehet në një normalitet. Vetëm muajt e fundit kanë ndodhur aq shumë vrasje mafioze dhe makabritete sa që kemi filluar të kemi frikë të dalim rrugëve. Unë refuzoj të pranoj broçkullat tuaja, që deklaroni se shqiptarët largohen për shkak të fenomeneve globale. Asnjë njeri nuk ikën nga vendi i tij nëse ky i fundit i garanton kushtet bazike, por kushtet bazike mungojnë sot. E vërteta është që nuk fshiheni dot më pas gishtit. INSTAT- i ka 3 vjet pa nxjerrë censusin, por shpopullimi që po ndodh është vepra më antikombëtare në historinë e demokracisë.

Baballarët tuaj dikur i digjin njerëzit me napalm, ndërsa ju i dëboni me gomone nëpër kampe emigrantësh rrugëve të botës, të braktisur dhe të pashpresë. Po ikën e ardhmja, po na ikën rinia. E nderuar, zonja Ministre e Arsimit, pavarësisht se sot nuk jeni prezentë në sallë dua t'ju them se shifrat nga raportet e fundit për boshatisjen e shkollave janë të dhimbshme. Aq në dijeni të situatës jeni sa keni filluar të justifikoni paaftësinë tuaj me forca të jashtme, si: plakja e popullsisë në Perëndim. Si mundeni ju, një politikëbërëse, të flisni vetëm për pasoja influencash të huaja dhe të mos jepni një zgjidhje apo të paktën të mos mbani përgjegjësi për murtajën që keni mbjellë me duart tuaja?!

Të rinjtë ikin, sepse nuk ka tranzicion organik nga arsimit në tregun e punës, ikin sepse me 400 mijë lekë të vjetër rrogë nuk del llogaria për të mbajtur frymën gjalle me bukë dhe ujë. Jemi në pikën ku po rrezikohen të shkrihen shkollat me njëra-tjetrën, sepse nëpër fshatra nuk ka më nxënës. Me çfarë të ardhurash do të jetojnë ata mësues që punojnë në ato shkolla? Sigurisht që ju do t'i flakni rrugëve, duke i detyruar t'i bashkohen valës së madhe të eksodit që ka pushtuar

vendin. Në arsimin profesional janë regjistruar rënie dramatike me përgjysmim të numrit të regjistrimeve nga afërsisht 20 mijë në 10 mijë.

Rënia nisi në vitin 2015 dhe u thellua në vitin 2017. Ky raport dëshmon se vendin e pret një situatë e vështirë me mungesa të theksuara profesionistësh në këtë sektor. Si të mos mjaftonte kjo, këtë vit trysnia e rritjes së çmimeve do të vështirësojë ndjeshëm transportin e nxënësve nëpër shkolla. Për këtë jam mjaft e qetë se kam bindjen që ky shpenzim do të kompensohet nga larja e rrobave me 30 gradë, ose siç tha zonja ministre, kur po mendonte për qytetarët, se edhe hapja shpesh e frigoriferit harxhon energji. Jeni bërë qesharakë! Çfarë mund të presësh nga ju? Tani pres vetëm ditën që të nxirrni ndonjë VKM për larjen e rrobave me dorë. E- Albania është perla e vërtetë e qeverisë “Rama” dhe arsyeja pse shumë shqiptarë hasin vështirësi për të aksesuar shërbimet më bazë që një vend duhet të ofrojë.

Thatë se do të hiqnit radhët e gjata nga sportelet, por, në fakt, u keni mbyllur derën qytetarëve që nuk kanë më as ku të trokasin për të zgjidhur një hall. Thatë se shërbimet do të ishin një klikim larg, por nuk menduat kurrë për ata që nuk mundën të aksesojnë internetin, siç janë moshat e treta apo ata që u përkasin grupeve vulnerabël të shoqërisë. Zonja Ministre e Arsimit, me siguri ju e dini sa nxënës nuk kanë mundur të regjistrohen për herë të parë apo sa nuk kanë mundur të shpërngulen për shkak se e-Albania nuk ka qenë funksionale. Vetëm në qarkun e Fierit 200 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë mundur të regjistrohen në shkollë për shkak të digjitalizimit tuaj futurist.

Jeni po ju që keni shkaktuar thellim të pabarazive duke vendosur në rrezik edhe shtresat në nevojë. Ju drejtova juve, sepse keni qenë pedagoge vetë dhe diku në thellësinë e nënvetëdijes suaj mendoj se ndieni përgjegjësi që i keni mohuar të drejtën për arsim fëmijëve të familjeve që nuk mund të kenë akses tek e madhërishmja e-Albania! Për t’u kthyer pak te pedagogët, protesta e të cilëve sot është më se legjitime, madje do të thosha e vonuar. Si rrjedhojë edhe e pozicionit tuaj, zonja Ministre, që prej vitit 2004 nuk ka pasur asnjë tentativë për rritjen e pagave të tyre duke e lënë kështu Shqipërinë të fundit në rajon si vendi me pagat më të ulëta për pedagogët.

Në fakt, sot dëgjova një koment të zotit Braçe për pagat e pedagogëve, kur tha se janë rritur rrogat në vitin 2017. Në fakt, ai ka qenë thjesht një indeksim. Për të qenë më konkrete do të bëj një krahasim me Kosovën, që sipas një studimi të bërë nga organizata për rritjen e cilësisë në arsim, të titulluar “Borgjezia e akademisë”, hulumtimi i të ardhurave personale të stafit akademik menaxherial në universitetin publik të Kosovës, publikuar në Prishtinë në vitin 2019, pagat bazë të pedagogëve në Kosovë janë nga 772 euro asistent profesor, deri në 1429 euro profesor. Këtyre iu shtohen edhe shtesa të tjera për funksione të ndryshme ose edhe detyra shtesë, duke arritur paga mujore deri në 3500 euro në muaj.

E për të mos mjaftuar, arsimi nuk është vetëm një prej hallkave të sistemit të dëmtuar nga çorba e e-Albania. A e dini ju, Ministre e Bujqësisë, se sa fermerë nuk dinë sesi të përdorin internetin, flas për skemat e mëdha që trumbetoni si arritje kolosale dhe që ia servirni fermerit si arritje shekullore? A e dini ju, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, se sistemi i e-Albania, apo i QKB-së, apo dhe sistemi i faturave nuk po punojnë? A e keni llogaritur dëmin që po i bëhet biznesit? A keni gjetur ju mënyra alternative për të bërë punën tuaj? E theksoj, punën tuaj, sepse, nëse nuk e dini ende se cila është vërtet përgjegjësia juaj, më lejoni t’ju sjell në vëmendje se detyra juaj është t’i shërbeni çdo qytetari shqiptar pa asnjë dallim.

Mos harroni që me taksat e tyre, ju ushqeheni, vidhni tenderë dhe madje shkoni edhe në udhëtime me stil oligarkësh. Apo jo, zonja Balluku? Sa më tepër kaloni kohë në pushtet, aq më tepër fjalët tuaja kthehen në mashtrime, propaganda në helm dhe, pa diskutim, veprat tuaja kanë humbur edhe njerëzoren. Faleminderit!